

2 Dita ndërkombëtare e kujdesit
Më shumë mirënjohje për personelin e kujdesit!

3 Votimi i Ligjit të ri kundër terrorizmit
Jo paragrafëve arbitrar me 13 qershor 2021!

4 Rishikimi i rregullorës mbi tatimin burimor
Ndikimet e pasojat e padrejta për migrnt*et

Nr. 3 | mund 2021 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

Bashkimi i forcave përparimtare

Betejat sindikaliste janë të lidhura me lëvizjet shoqërore!



Pamje nga greva madhështore e grave me 14 qershor 2019 në Bernë

Black Lives Matter (lëvizja transnacionale kundër dhunës ndaj njerëzve me ngjyrë), greva e grave, greva e klimës. Para syve tanë lindin e zhvillohen lëvizje të fuqishme për drejtësi sociale. Çka domethënë kjo për sindikatat: Këto beteja sociale neve nuk na ndajnë, ne jemi pjesë e tyre.

Marie Saulnier Bloch

Lëvizjet sociale mund ti bëjnë bashkë njerëzit e gjeneratave dhe sfoneve të ndryshme. Ato na bëjnë të ndiejmë se çfarë force mund të krijohet nga të vepruarit përbashkët. Ato tregojnë se çka mund të arrijmë ne, kur ne të bashkuar kërkojmë diçka. Sindikatat kanë lindur me të njëjtën bindje: të mbrojnë interesat e kolektive dhe individuale e të gjithë punëmarrësve dhe të këmbëngulin që ne nuk jemi instrumente, por jemi qenie njerëzore.

Njerëzit formalisht janë të njëjtë, mirëpo në realitet të pabarabartë. Njerëz të ndryshëm në pamje, histori, probleme. Për të qenë ne "Ne", duhet që secila fytyrë, secila histori dhe secili problem të respektohet e të vlerësohet. Ajo që ne kemi të përbashkët, është qëllimi ynë dhe e ardhmja

e jonë përbashkët. Kur ne si anëtarë sindikate kërkojmë dhënien fund të pabarazisë dhe të përfitimeve në kurriz tonë, kjo nuk guxon të jetë fjalë boshe. Nëse njerëzit diskriminohen se janë migrant*ë, gra, të zinj, të ri pleq, Sans-Papiers (pa letra), homoseksual, lezbike ose trans, refugjatë, atëherë jemi të prekur të gjithë ne.

Qysh në shekullin e 19'të përmes shkëmbimit mes kolektiveve feministe dhe sindikalisteve, ishte mundësuar bashkimi e solidarizimi për të luftuar për barazi.

Në shekullin e 20'të shumë sindikalist*ë mendonin sikur borgezia ksenofobe, se një kufizim i migracionit do të kishte ndikime pozitive përkitazi me punësimin dhe pagat. Lëvizja sindikaliste e ka parë

dhe njohur gabimin e saj! Për sindikatat është e qartë se të drejtat për të gjithë nuk mund të funksionojë pa solidarizimin mes koleg*eve.

Në shekullin e 21'të ne pyesim veten edhe më tej, përse angazhohet Unia në lëvizjen klimatike. Për të thënë qartas: Nuk ka vende pune në një planet të vdekur. Ne nuk jetojmë në izolim. Shfrytëzimi i fuqisë punëtore dhe burimeve nuk nje kufij. Edhe para natyrës jo. Me pasoja shkatërrimtare për të ardhmen e planetit tonë.

Lëvizjet sociale kërkojnë një ndryshim rrënjësor

Për ti dhënë fund një sistemi, i cili orientohet në përfitimin afatshkurtër në dobi të një pakice të privilegjuar. Shfrytëzimi i natyrës dhe njeriut përmes rritjes së verbër ekonomike,

patriarkatit e imperializmit, bashkë janë pengesat për një shoqëri të drejtë, demokratike dhe të qëndrueshme. Ky është mesazhi i manifestit «Strike for Future» («Greva për ardhmërinë»), i cili është bërë publik me 6 prill dhe i cili apelon për një mobilizim në shkallë të gjerë për datën 21 maj. Lidhja bënë bashkë grevën e klimës, sindikatat, grupet feministe dhe organizatat tjera të shoqërisë civile.

Për një «lidhje të betejave» nevojitet «lidhja e resurseve» fton aktivist*et të organizohet në aspektin sindikal. Kolektivet feministe dhe organizatat kundër-raciste ftojnë për solidarizim. Andaj ne duhet të ndërlihim e bashkojmë forcat tona!

Editorial



Ndërlidhja e betejave emancipuese, feministe, kundër-raciste

Ky tregim më ka magjepsur si nxënës: Mbreti ishte në shtratit e vdekjes. Përreth tij janë grumbulluar fëmijët e tij. Në krah të shtratit të mbretit në një tavolinë në njërin anë është vendosur një shkop i vetme dhe në tjetrën një grumbull shkopinjsh. Ai i kërkon fëmijës më të vogël që të thyej shkopin e vetëm. Ai e merr edhe e thyen atë pa ndonjë mundim. Më pas, mbreti u drejtohet të gjithë fëmijëve: «Merrni tani grumbullin e tërë me shkopinj dhe provoni ti thyeni» Të gjithë fëmijët njëri pas tjetrit provuan ti thyejnë. Shkopinjtë bashkë nuk thyeshin dot.

Këtë histori në forma të ndryshme tregimi e figurash më ka ra ta dëgjoj edhe më vonë: një plakë e urtë, një luftëtarë plak, një udhëheqës partizan. Morali i historisë: Nëse ne qëndrojmë te bashkuar, nuk mund të na thyejnë.

Çka domethënë kjo histori përshtatur në aktualitetin tonë shoqëror ë stigmatizimit, të diskurseve ideologjike, të konfliktit të gjeneratave shpesh të përfolur, të politikës së fajësimit karshi migrant*eve, të shkatërrimit të ambientit në emër të mirëqenies dhe zhvillimit ekonomik, të individualizimit të shoqërisë?

Si mund të shënojë sukses bashkimi i forcave për një shoqëri solidare, ekologjike dhe me barazi sociale, duam ta bëjmë temë të përhershme në Horizonte. Dhe po, ne të gjithë mund të bashkohemi në ditën e aksionit me 21 maj. Dhe me 14 qershor duam të protestojmë kundër diskriminimit të grave, ndër të tjerë shumë migrant*ë. Beteja feministe për barazi dhe drejtësi shoqërore është edhe një betejë për pozitë më të mirë juridike të migrant*eve. Ne llogarisim në solidarizimin Tuaj!

Hilmi Gashi

Ju pyesni, Unia përgjigjet

Nëna e sëmure: A guxojë ta marrë të lirë për tu kujdesur për te?

Nëna ime është sëmure. Ajo edhe më tej jeton vet në banesën e saj. Unë dua me dëshirë të kujdesem për te dhe për këtë dua ta marr të lirë. A guxoi?

Regula Dick: Po. Që nga 1 janari 2021 ekziston e drejta e mungesës afatshkurtër nga puna në rast të nevojës së kujdesit për anëtarë të familjes të sëmure apo të aksidentuar. Lejohen më së shumti 3 ditë punë për rast, dhe u duhet të dëshmoni rastin me dëftesë mjekësore. Kjo vlen për të afërmit në linjë poshtë-lartë, pra edhe për prindërit dhe për fëmijët tuaj. Gjithashtu edhe për vjehërrinë, vëllezërit e motrat dhe partnerët jetësor, çka është e vërteta vetëm nëse këta kanë jetuar për së paku 5 vite në të njëjtën amvisni. Firma ua ka borxh pagën për 3 ditët e mungesës nga puna. Në vit mund të merren më së shumti 10 ditë të lira, përjashtuar rastet kur është fjala për fëmijët tuaj. Në këtë rast nuk vlen kufizimi kohor. E drejta e kësaj mungese afatshkurtër nga puna rrjedh nga Neni 329 h i të drejtës obliguese deh Neni 36, Paragrafi 3 dhe 4 i ligjit të punës. Tek fëmijët pas kalimit të 3 ditëve sipas rrethanave është edhe më tej e mundur mungesa dhe të kërkohet e drejta e vazhimit të pagës, mbështetur në Nenin 324 të së drejtës obliguese, pasi që për kujdesin e tyre ekziston edhe detyrimi ligjor.

(Work, 19.3.2021)

Pensionin i invaliditetit IV/AI: A duhet të paguaj kontributet për sigurimet shoqërore AHV/AVS?

Unë shkakun i një sëmundje të rëndë ka një kohë të gjatë që jam i paaftë për punë dhe jam lajmëruar tek sigurimi i invaliditetit (IV/AI). Tani sigurimi i invaliditetit IV/AI ma ka komunikuar që unë me retroaktivitet nga 1 janari 2020 do të përfitojë pensionin tim të invaliditetit. A duhet që unë nga përfitimet e pensionit të paguaj edhe kontributet e sigurimeve shoqërore AHV/AVS?

Regula Dick: Po. Kush përfiton nga sigurimi i invaliditetit IV/AI, duhet që edhe më tej të paguajë kontributet për sigurimet shoqërore AHV/AVS dhe EO. Ju keni borxh kontributet edhe nëse nuk jeni në marrëdhënie pune dhe duhet të lajmërohëni shkaku i evidentimit tek arka kantonale e kompensimit apo tek dega e saj në komunën tuaj. Detyrimi i kontributeve mbaron tek kur të arrihet mosha e rregullt e pensionimit të pleqërisë dhe kur ju nuk jeni më duke punuar. Për burra mosha e pensionimit është 65 vjeç, ndërsa për gra 64 vjeç. Si jo i punësuar ju nuk do të duhet të paguani kontribute nëse jeni i martuar dhe bashkëshortja juaj është ende në marrëdhënie pune dhe paguan kontribute në lartësinë prej së paku 1006 franga.

(Work, 19.3.2021)

Korona: Marrja e pushimit shkakun i sëmundjes së shefit?

Unë jam në vitin e parë si shegert në zdrukthetari. Ndërmarrja ku unë bëjë praktikën është shumë e vogël, krahas shefit tim punon vetëm edhe një punonjës. Javën e kaluar shefi im shkakun i koronës ishte në izolim, ndërsa kolegu im ishte në pushim. Shefi më ka informuar, se për këtë arsye ndërmarrja mbetet e mbyllur dhe se unë në këtë javë nuk duhet të dal në punë. Tani më është hequr një javë pushimi. A është kjo e drejtë?

David Aeb: Jo. Nëse biznesi duhet të mbyllet për shkak të paparapara dhe punëdhënësi nuk mundet të pranojë kontributin e punës së punëmarrësve, atëherë ai gjendet në një situatë të ashtuquajtur vonesë e pranimit. Kështu mbylljes të paparashikuara kanë të bëjnë me rreziqe të punëdhënësit, të cilat nuk mund tu vihet për barrë punëmarrësve. Në rast të një vonesë të pranimit, punëdhënësi duhet më tej të paguajë pagën pa pasur nevojë që të kryhet puna më vonë. Për tu gjendur faktikisht punëdhënësi në vonesë, punëmarrësit duhet të ofrojnë punën e tyre (për arsye dëshmie më së miri me shkrim apo përmes E-mailit), që duan të punojnë. Vetëm nëse punëdhënësi shprehimisht ka heq dorë nga shërbimet e punëmarrësve apo nëse nga rrethanat vihet në përfundim se punëdhënësi nuk është në gjendje të pranojë shërbimet, bie poshtë detyrimi për të ofruar punën. Në rastin e parashtruar juve u është komunikuar që ndërmarrja është mbyllur. Në rrethana të tilla ju nuk duhet që në mënyrë të veçantë ti ofroni shërbime pune, dhe ju mbështetur në Nenin 324 të së drejtës obliguese në parim keni të drejtë të pagë gjatë javës kur ndërmarrja ka qenë e mbyllur. Nuk lejohet që juve tu hiqen pushimet.

(Work, 1.4.2021)

Rishikimi i rregullores së tatimit burimor

Urdhëresa tatimore e mundimshme për migrantët

Papritur migrantët e papunë kanë 500 franga më pak në kuletën e tyre. Për çdo muaj! Pas kësaj qëndron administrata tatimore federale.

Johannes Supe, work, 1 prill 2021 (e përshtatur)

Për shembull Giuseppe I.*: Babai i tre fëmijëve është i papunë. Megjithatë ai paguan tatimin gati sikur të gjithë të varurit nga paga, të cilët nuk kanë lehtë të përhershme qëndrimi. Në dhjetorin e fundit Giuseppe paguante 8.65 franga. Në janar 2021 papritur administrata tatimore kërkonte nga ai 238.05 franga. Njëjtë ka ndodhur edhe me Rika L.*, i cili ka dy fëmijë dhe është duke kërkuar punë. Zbritjet tatimore nga paga që ishin nën 40 franga u rritën mbi 600 franga. Çka ka ndodhur?

Logjika e autoriteteve

Në janar 2021 është fuqizuar rregulloja e rishikuar e tatimit burimor, në mënyrë që ta optimizoj procedurën. Rezultati: Ajo çka autoriteteve ua thjeshtëzon llogaritjen, ua vështirëson migrantëve të papunë me fëmijë jetën.

Deri më tani zbritjet për fëmijë janë llogaritur në tatime. Tani administrata tatimore vepron sikur të mos kishte

zbritje për fëmijë. Rezultati: Përderisa me 2020 kishte vetëm zbritje të vogla të tatimit burimor, tanimë janë disa qindra franga. Kjo shkakun i «kodit tarifor G», tek i cili janë të papunët. Në fund të vitit të takuarit kishin mundësinë që zbritjet e larta të parave tu kompensohen nga kantonet. Mirëpo fëmijët duhet të ushqehen, vesh-mbathën e të përkuj-

desen edhe gjatë tërë vitit. Pos kësaj, tani rishtas, paguesit e tatimit burimor të papunë, taksohen bazuar në pagat e tyre të mëhershme në vend të parave më të pakta që marrin nga mëditjet e të papunëve. Edhe koleget e kolegët me shumë vende pune janë të prekur me këtë rast. Bashkimi i Sindikatave të Zvicrës ka intervenuar tek administrata tatimore. Me sukses. Së paku këto kontributet e tepërta të paguara deri në maj duhet tu kthehen prapa.

Ndikimet e padëshiruara

Tek sekretariati shtetëror për ekonomi (Seco) janë të tmerruar me ndikimet e rishikimit në fjalë. Tani është duke u punuar për «zgjidhje në një të ardhme mesatare dhe afatgjatë». Koha e pritjes: viti 2022. Se a do të jetë përfundimisht i nevojshëm një rishikim i rishikimit të urdhëresës së tatimit burimor, është ende e paqartë.

* emrat e ndryshuar



Betejat sindikaliste në Kosovë

Në vitet e fundit kur sindikatat të trashëguara sistemore në Kosovë sikur gjithandej në Evropën juglindore nuk janë në hap me kohën dhe rrethanat, në skenë kanë dalë nisma të reja që i japin shtytje të re lëvizjes punëtore dhe asaj shoqërore dhe me aktivitetin e tyre që mund të nxisin edhe një reformë gjithëpërfshirëse sindikaliste në Kosovë.

Osman Osmani

Një kolektiv me Grupi Anarko-Sindikalist i Prishtinës ka disa vite që kanë dalë në skenën publike përmes nismave aktive dhe bashkë-organizimit të manifestimeve nga të cilat mund të veçohet atë të ditës ndërkombëtare të punëtorëve 1-Majin dhe të ditës ndërkombëtare të gruas 8-Marsin.



Kush është GASP dhe çka ka të përbashkët me sindikatat?

Grupi Anarko-Sindikalist i Prishtinës (GASP) është grup aktivist*esh që synon organizimin e klasës punëtore nëpër sindikata radikale antikapitaliste, që duan të shërbejnë jo vetëm për mbrojtjen e interesit të punëtorëve në 'vend të punës, por edhe si organizata revolucionare. Vetë GASP-i nuk është sindikatë edhe pse në raste konflikti ndërmjet punëdhënësit me njërin prej anëtarëve të GASP, ne mobilizohemi si të tillë. Më saktë do të ishte, që GASP të cilësohet si grup lokal sindikalist, që në traditën anarko-sindikaliste shkon përtej organizimit

sektorial dhe funksion si urë lidhëse ndërmjet punëtorëve*eve të 'sektorëve të ndryshëm, të papunëve, si dhe studentëve.

Çfarë veprimesh janë ndërmarrë deri më tani dhe me ç'kërkesa?

Aktivitetet e GASP kanë qenë të lloj-llojshme, por kryesisht është marrë me ndihmë, këshillim, organizim në vend të 'punës, aksione simbolike dhe të drejtpërdrejta, krijim dhe përkthim literature etj. Po veçojmë disa: përpjekjet e përbashkëta me punëtorët e pastrimit të konvikteve si dhe ato të Fakultetit Filozofik, me punëtorët e elektro-disribucionit KEDS, aksioni i drejtpërdrejtë kundër NIKE, aksion solidarizimi dhe simbolik prej kullës të katedrales, organizimi i protestës për 1 Maj dhe marrja pjesë në organizimin e protestave «Pronto», 8 Marsi, IDAHOT, iniciativa për bibliotekë anarkiste (përkthim të 'librave dhe eseve) etj. Varësisht prej aksioneve, kryesisht përdorim emrin e GASP-it apo Bllokut Anti-autoritar/Anti-kapitalist.

Po me 1-Maj 2021?

Sivjet për 1 maj gjithashtu është organizuar marsh/proteste, kryesisht nga 4 grupe dhe disa individë. Gjithashtu protestës iu kanë përgjigj pozitivisht edhe 2 sindikata (Sindikata e Re e KEK edhe Sindikata e re e KOSTT), gjithashtu edhe disa punëtorë të përjashtuar nga KEDS iu janë bashkëngjitur organizimit. Duhet me theksua që BSPK (konfederata e vetme sindikale në Kosovë) për këtë 1 maj (si në shumë 1 maj-a tjerë) ka ra në gjumë edhe nuk ka organizuar asgjë.